

Efekti i patentave europiane në Shqipëri

1. “Aplikim për patentë europiane” është aplikimi për një patentë europiane të depozituar më ose pas 1 majit 2010, në përputhje me Konventën Europiane për Patentat (KEP), si dhe aplikimi ndërkombëtar i depozituar më ose pas 1 majit 2010, sipas traktatit të bashkëpunimit për patentë, për të cilin Zyra Europiane e Patentave (ZEP) vepron si zyrë e caktuar ose e zgjedhur, aplikime në të cilat është e caktuar Shqipëria;
2. “Patentë europiane” është patenta europiane e dhënë nga ZEP-i, në bazë të aplikimit për patentë europiane, për të cilën është caktuar Shqipëria; c) “Aplikim për patentë kombëtare” është aplikimi për patentë, që depozitohet në DPPM, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
3. “Patentë kombëtare” është patenta e dhënë në bazë të këtij ligji. 2. Aplikimi për patentë europiane dhe patenta europiane, sipas dispozitave të këtij ligji, kanë të njëjtin efekt dhe u nënshtrohen të njëjtave kërkesa si aplikimi për patentë kombëtare dhe patenta kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.

Depozitimi i aplikimit për patentë europiane

1. Aplikimi për patentë europiane mund të depozitohet në:

a) ZEP;

b) DPPM.

2. Një aplikim i ndarë për patentë europiane dhe aplikimi i ri për patentë evropiane, sipas shkronjës “b”, paragrafi 1, i nenit 61, të KEP-it, depozitohen direkt në ZEP.

3. Kur shpikja në fjalë është me interes për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, aplikuesi me vendbanim ose vendqëndrim në Shqipëri e depoziton aplikimin për patentë europiane vetëm në DPPM.

4. Aplikimi për patentë europiane i depozituar në DPPM ka të njëjtin efekt sikur të ishte depozituar në të njëjtën datë në ZEP, me kusht që DPPM-ja t’ia ketë transmetuar atë ZEP-it, në përputhje me dispozitat e KEP- it.

5. Aplikimi për patentë europiane, që depozitohet në DPPM, mund të depozitohet në çdo gjuhë të parashikuar në paragrafët 1 dhe 2, të nenit 14, të KEP-it.

6. Nëse nga aplikimi që depozitohet në DPPM nuk del qartë që aplikimi është për patentë europiane, atëherë aplikuesi duhet të depozitojë një deklaram në gjuhën shqipe apo angleze, me anë të të cilit kërkohet një patentë europiane.

Tarifat dhe kostot procedurale për aplikimet për patentë europiane

Tarifat dhe kostot procedurale për aplikimet për patentë europiane i paguhen ZEP-it në përputhje me parashikimet e KEP-it.

Efektet e aplikimit për patentë europiane

1. Aplikimi për patentë europiane, të cilit i është dhënë një datë depozitimi, është i njëjtë me një aplikim

të rregullt për patentë kombëtare dhe, kur është rasti, merret parasysh prioriteti i kërkuar në aplikimin për patentë europiane, pavarësisht nga përfundimi që do të ketë aplikimi.

2. Aplikimi për patentë europiane i publikuar i siguron aplikuesit të saj të njëjtën mbrojtje që ofron aplikimi për patentë kombëtare, i publikuar, duke filluar nga data në të cilën përkthimi në shqip i pretendimeve të aplikimit për patentë europiane të publikuar është publikuar nga DPPM-ja.

3. Aplikimi për patentë europiane vlerësohet se nuk i ka sjellë, që nga fillimi, pasojat e përmendura në pikën 2, të këtij neni, nëse është tërhequr, mendohet se është tërhequr, është refuzuar përfundimisht ose nëse përcaktimi i Shqipërisë është tërhequr apo konsiderohet si i tërhequr.